1. **Lista e dokumentacionit të nevojshëm është:**

Për të dhënat personale:

- Certifikata e lindjes/personale së aplikantit dhe certifikata familjare (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);

- Vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetqeverisjes vendore, ku kërkohet strehim social, për familjet që kanë lëvizur nga zonat e tjera të vendit

Për vërtetimin e kushteve të banimit:

- Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për pronat që disponohen ose jo në emër të secilit anëtar të madhor të familjes (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania); (vetem për Bashkinë Shkodër)

- Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për sipërfaqen e pronës që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);

- Vërtetim nese ka ose jo banesë ne proces legalizimi (e-Albania);

- Akt-verifikimi nga Bashkia për:

- Banesat në rrezik shembjeje; Rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore; Banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit;

- Vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;

Për vërtetimin e kushteve familjare:

- Çertifikatë familjare (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);

- Vendim i gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

Për vërtetimin e kushteve sociale:

- Vërtetim i Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar (KMCAP), për individë me aftësi ndryshe,

- Vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, për individët me statusin e jetimit;

- Dokument që vërteton që ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;

- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";

- Vërtetim pë r punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH), punonjësit e repartit RENEA, punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi,

- Urdhër mbrojtje apo urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje, lëshuar nga gjykata;.
- Vetëdeklarim nëse individi/familja i përket minoritetit kombëtar Rom apo Egjipti
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për familjet e minoritetit kombëtar Rom;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
- Vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;
- Dokument zyrtar të celebrimit dhe çertifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja;
- Vërtetim me çertifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë- nënë.

Për vërtetimin e kushteve ekonomike:

- Vërtetim i të ardhurave neto dhe bruto të familjes, vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikuesit e të personave të tjerë madhorë të familjes, që janë në marrëdhënie pune (vërtetim page për 3 muajt e fundit) (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe e Instituti i Sigurimeve Shoqërore për derdhjen e kontributeve për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vertetim për të ardhurat vjetore të bisnesit për përsonat e vetpunësuar
- Vërtetim nga Zyra e Ndihmës Ekonomike të bashkisë për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi ndryshe (sigurohet nga Bashkia);
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Punësimit për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania);
- Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për personat në pension (gjenerohet elektronikisht në platformën qeveritare e-Albania)
- **Kontratë qiraje e lidhur përpara noterit ndërmjet aplikuesit në cilësinë e qiramarrësit dhe pronarit në cilësinë e qiradhënësit**